



COUR EUROPEENNE DES DROITS DE L'HOMME
EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS

GJYKATA (DHOMA)

ÇËSHTJA RAIMONDO K. ITALISË

(Kërkesa nr. 12954/87)

VENDIM

STRASBURG

22 shkurt 1994

Në çështjen Raimondo kundër Italisë*,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e mbledhur në përputhje me nenin 43 (neni 43) të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa") dhe dispozitave përkatëse të Rregullores së Gjykatës, si Dhomë, e përbërë nga gjyqtarët e mëposhtëm:

- z. R. RYSSDAL, President,
- z. R. BERNHARDT,
- z. F. MATSCHER,
- z. C. RUSSO,
- znj. E. PALM,
- z. I. FOIGHEL,
- z. F. BIGI,
- z. L. WILDHABER,
- z. D. GOTCHEV,

dhe gjithashtu z. M.-A. EISSEN, sekretar, dhe z. H. PETZOLD, zëvendës sekretar,

pas shqyrtimit privatisht të çështjes më 23 shtator 1993 dhe 24 janar 1994, nxjerr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të përmendur:

PROCEDURA

1. Çështja iu referua Gjykatës nga Komisioni Evropian për të Drejtat e Njeriut ("Komisioni") më 18 janar 1993, brenda periudhës tre mujore të përcaktuar me nenin 32 para. 1 dhe neni 47 (neni 32-1, neni 47) i Konventës. Ajo rrjedh nga një kërkesë (nr. 12954/87) kundër Republikës Italiane të depozituar në Komision sipas nenit 25 (neni 25) nga një shtetas italian, z. Giuseppe Raimondo, më 23 prill 1987.

Kërkesa e Komisionit i referohet neneve 44 dhe 48 (neni 44, neni 48) dhe deklaratës me anë të së cilës Italia ka njohur juridiksionin e detyrueshëm të Gjykatës (neni 46) (neni 46). Objekti i kërkesës ishte marrja e një vendimi nëse faktet e çështjes nxjerrin në pah një shkelje nga shteti përgjegjës të detyrimeve të tij sipas nenit 6 para. 1 (neni 6-1) i Konventës, neni 1 i Protokollit nr. 1 (P1-1) dhe neni 2 i Protokollit nr. 4 (P4-2).

2. Në përgjigje të kërkesës së bërë në përputhje me nenin 33 para. 3 (d) të Rregullores së Gjykatës, znj. Pittelli, gruaja e z. Raimondo, dhe tre djemtë e tyre informuan sekretarin më 7 qershor 1993 për vdekjen përkatësisht të bashkëshortit dhe babait të tyre. Ata deklaruan se dëshironin të vazhdonin proceset dhe të merrnin pjesë në to dhe të përfaqësoheshin nga avokati që kishin caktuar (neni 30). Për arsye konsistence z. Raimondo do të vazhdojë të thirret "kërkuesi", edhe pse tani këtë

* Shënim nga Sekretari: Çështja merr numrin 1/1993/396/474. Numri i parë është pozicioni i çështjes në listën e çështjeve të referuara në Gjykatë në vitin përkatës (numri i dytë). Dy numrat e fundit tregojnë pozicionin e çështjes në listën e çështjeve të referuara në Gjykatë që nga krijimi i saj dhe në listën e kërkesave përkatëse origjinuese për Komisionin.

status e kanë e veja dhe tre djemtë e tij (shih, ndër të tjera, vendimin në çështjen *Pandolfelli dhe Palumbo kundër Italisë*, datë 27 shkurt 1992, Seritë A nr. 231-B, f. 16, para. 2).

Znj. Pittelli dhe djemtë e saj ranë dakord gjithashtu për nxjerrjen e identitetit të z. Raimondo, i cili fillimisht ishte referuar me inicialet G. R.

3. Dhoma që u krijua përfshinte ex officio z. C. Russo, gjyqtarin e zgjedhur me kombësi italiane (neni 43 i Konventës) (neni 43) dhe z. R. Ryssdal, Kryetarin e Gjykatës (neni 21 para. 3 (b) i Rregullores). Më 27 shkurt 1993, z. R. Bernhardt, Nënkryetar i Gjykatës, hodhi shortin, në prani të sekretarit, dhe caktoi emrat e shtatë anëtarëve të tjerë, përkatësisht z. Bernhardt, z. F. Matscher, znj. E. Palm, z. I. Foighel, Z. F. Bigi, z. L. Wildhaber dhe z. D. Gotchev (neni 43 në pajtim me Konventës dhe neni 21 para. 4 i Rregullores) (neni 43).

4. Si President i Dhomës (neni 21, para. 5 i Rregullores), z. Ryssdal, duke vepruar nëpërmjet sekretarit, u konsultua me Agjentin e Qeverisë Italiane ("Qeveria"), avokatin e kërkuesit dhe delegatin e Komisionit për organizimin e proceseve (neni 37 para. 1 dhe 38 i Rregullores). Në bazë të urdhrit të dhënë si rezultat, sekretari mori dosjen e kërkuesit më 12 korrik 1993 dhe dosjen e qeverisë më 30 korrik. Përfaqësuesi i Komisionit nuk paraqiti vërejtje me shkrim.

5. Më 6 shtator 1993, Komisioni paraqiti dosjen mbi proceset përpara gjykatës, siç u kërkua nga sekretari sipas udhëzimeve të Presidentit.

6. Në përputhje me vendimin e Presidentit, i cili i kishte dhënë kërkuesit leje për të përdorur gjuhën italiane (neni 27 para. 3 i Rregullores), seanca u zhvillua me dyer të hapura për publikun në Ndërtesën e të Drejtave të Njeriut, në Strasburg, më 20 shtator 1993. Gjykata kishte mbajtur paraprakisht një mbledhje përgatitore.

Përpara Gjykatës u paraqitën:

(a) Për qeverinë

z. G. RAIMONDI, magjistrat,
i atashuar në Shërbimin Diplomatik Ligjor
të Ministrisë së Punëve të Jashtme,

Bashkëagjent,

z. E. SELVAGGI, Shef i Departamentit për të Drejtat e Njeriut,
Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Penale, Ministria e Drejtësisë, Avokat;

(b) Për Komisionin

z. E. BUSUTTIL,

Përfaqësues;

(c) Për kërkuesin

z. M. Mellini, avokat,

Avokat.

Gjykata dëgjoi fjalimet e përfaqësuesve të lartpërmendur, të cilët gjithashtu iu përgjigjën pyetjeve të saj.

Më 14 tetor 1993, Qeveria dha informacion shtesë. Komisioni parashtrroi komentet e tij me shkrim më 11 dhjetor.

LIDHUR ME FAKTET

I. RRETHANAT KONKRETE TË ÇËSHTJES

7. Z. Giuseppe Raimondo, një sipërmarrës në sektorin e ndërtimit, jetoi në Davoli (Catanzaro) deri në vdekjen e tij më 11 korrik 1992.

Ndaj tij u nis një proces penal pasi dyshohej se i përkiste një organizate të tipit mafioz që vepronte në rajonin e Soveratos. Në të njëjtën kohë ndaj tij u morën masa të ndryshme parandaluese.

A. Procesi penal

8. Më 24 korrik 1984, Prokurori Publik i Catanzaros lëshoi një urdhër për arrestimin e shtatëmbëdhjetë personave, përfshirë edhe kërkuesin. Pasi fillimisht iu shmang arrestimit sipas këtij urdhri, kërkuesi iu dorëzua autoriteteve më 7 nëntor 1984 dhe u dërgua menjëherë në paraburgim.

9. Hetimi përfundoi më 24 korrik 1985 dhe z. Raimondo u çua për gjykim në Gjykatën e Distriktit Catanzaro me katërmëdhjetë të bashkëpandehur të tjerë. Paraburgimi i tij u zëvendësuar me arrest në shtëpi (*arresti domiciliari*).

10. Më 8 tetor 1985, në seancën e parë, Gjykata e Rrethit urdhëroi bashkimin e çështjes me dy persona të tjerë dhe urdhëroi përfshirjen në dosje të disa dokumente. Më pas, ajo e shtyu procesin për më 16 janar 1986.

Më 30 janar 1986, Gjykata e Rrethit e liroi z. Raimondo për shkak të provave të pamjaftueshme (*assoluzione per insufficienza di prove*) si dhe revokoi urdhrin për vendosjen e tij në arrest shtëpie.

11. Gjatë dhënies së vendimit më 16 janar 1987 mbi apelet e prokurorit publik dhe z. Raimondo, Gjykata e Apelit e Catanzaros e liroi këtë të fundit me arsyetimin se nuk ishin vërtetuar faktet materiale të veprës penale (*perche il fatto non sussiste*). Në Gjykatën e Kasacionit nuk u parashtrua ankesë.

B. Procesi në lidhje me masat parandaluese

1. Në Gjykatën e Rrethit Catanzaro

12. Më 16 janar 1985, Prokurori Publik i Catanzaros iu drejtua Gjykatës së Rrethit për një urdhër për vendosjen e z. Raimondo nën mbikëqyrje të posaçme policore dhe për sekuestrimin parandalues të disa pasurive me qëllim konfiskimin e tyre të mundshëm (Akti nr. 1423 i 27 dhjetorit 1956 dhe Akti nr. 575, datë 31 maj 1965, i ndryshuar nga Akti nr. 646, datë 13 shtator 1982 - shih paragrafët 16-18 më poshtë). Ai e bazoi kërkesën e tij në një raport të karabinierëve të Soveratos, datë 27 dhjetor 1984.

13. Më 13 maj 1985, Gjykata e Rrethit urdhëroi sekuestrimin e gjashtëmbëdhjetë objekteve prone të patundshme (dhjetë parcela toke dhe gjashtë ndërtesa) dhe të gjashtë automjeteve, të cilat të gjitha dukej se ishin në zotërim të kërkuesit. Masa u regjistrua në regjistrat përkatës publikë më 15 maj

1985.

Më 16 tetor, Gjykata e Rrethit revokoi sekuestrimin e disa pronave që i përkisnin palëve të treta. Nga ana tjetër, ajo urdhëroi konfiskimin e disa prej ndërtesave të sekuestruara, pronarë të cilave ishin kërkuesi dhe gruaja e tij, dhe të katër automjeteve, me arsyetimin se nuk ishte vërtetuar se pasuritë në fjalë ishin "fituar në mënyrë të ligjshme". Konfiskimi u regjistrua në regjistër më 9 nëntor 1985.

Me të njëjtin vendim z. Raimondo u vu nën mbikëqyrjen e posaçme policore, e cila megjithatë nuk hyri në fuqi deri më 30 janar 1986, ditën kur ai u shpall i pafajshëm nga Gjykata e Rrethit (shih paragrafin 10 më lart). Atij iu kërkua gjithashtu të jepte një garanci prej 2,000,000 lirash italiane si garanci për t'u siguruar që ai i respektonte kufizimet që i bashkëngjiteshin kësaj mase, përkatësisht ndalimin e daljes nga shtëpia pa informuar policinë; detyrimin për t'u paraqitur në polici në ditët e kërkuara për këtë; detyrimin për t'u kthyer në shtëpi deri në orën 21:00 dhe të mos u larguar nga shtëpia para orës 7 të mëngjesit, përveç nëse ai kishte arsye të vlefshme për ta bërë këtë dhe kishte njoftuar fillimisht autoritetet përkatëse për qëllimin e tij.

2. Në Gjykatën e Apelit Catanzaro

14. Lidhur me kundërshtimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Catanzaro mori vendim në një seancë private më 4 korrik 1986. Ajo anuloi masën e posaçme të mbikëqyrjes dhe urdhëroi kthimin e garancisë dhe pronës së sekuestruar dhe të konfiskuar. Vendimi i saj (*dekreto*) i referohej "mënyrës shqetësuese rastësore me të cilën ishin miratuar masat parandaluese të kundërshtuara në lidhje me personin dhe pronën e z. Raimondo, duke dekretuar kështu vdekjen e tij civile dhe ekonomike".

Vendimi u depozitua në sekretari më 2 dhjetor 1986 dhe u nënshkrua nga zyrtari përkatës i organit të akuzës më 10 dhjetor. Përsëri më 2 dhjetor, sekretaria e Gjykatës së Apelit njoftoi autoritetet kompetente të policisë (*questura*) për vendimin, të cilat, më 5 dhjetor, informuan karabinierët vendas për vendimin. Këta të fundit informuan kërkuesin më 20 dhjetor.

Vendimi mori formë të prerë më 31 dhjetor 1986.

15. Revokimi i sekuestrimit të pasurisë së patundshme dhe i konfiskimit të automjeteve është regjistruar në regjistrat përkatës më 2 shkurt (pasuri e patundshme), 10 shkurt (dy makina dhe një furgon) dhe 10 korrik 1987 (një kamion).

Garancia iu khye kërkuesit më 24 prill 1987.

Për pasurinë e patundshme që ishte konfiskuar, kërkesat për hedhjen në regjistrin e revokimit të masës mbajnë datën 9 gusht 1991.

II. LIGJI KOMBËTAR I ZBATUESHËM

A. Legjislacioni në fuqi në kohën materiale

1. Akti datë 27 dhjetor 1956

16. Akti nr. 1423, datë 27 dhjetor 1956 ("Akti i 1956-ës") parashikon masa të ndryshme parandaluese në lidhje me "personat që paraqesin rrezik për sigurinë

dhe moralin publik". Dispozitat përkatëse përmblihen në vendimin *Guzzardi kundër Italisë*, datë 6 nëntor 1980. (Seritë A nr. 39, f. 17-19, §§ 46-49):

"46. Sipas seksionit 1, ligji zbatohet, ndër të tjera, për ... individët të cilët, për shkak të sjelljes dhe stilit të tyre të jetës (*tenore di vita*), duhet të konsiderohen se jetojnë zakonisht, qoftë edhe pjesërisht, me produktet e krimit ose me shpërblimet për bashkëpunimin me të (*con il favoreggiamento*), ose sjellja e jashtme e të cilëve jep arsye bindëse për të besuar se ata kanë prirje kriminale (*che, per le manifestazioni cui abbiamo dato luogo, diano fondato motivo di ritenere che siano proclivi a delinquere*).

Shefi i Policisë [(*questore*)] mund t'u dërgojë këtyre personave një paralajmërim (*diffida*) ...

47. ...

48 [një person i tillë], sipas nenit 3, mund të vendoset nën mbikëqyrje të posaçme policore (*sorveglianza speciale della pubblica sicurezza*); nëse është e nevojshme, kjo mund të kombinohet ose me një ndalim të qëndrimit në një ose më shumë rrethe ose provinca të caktuara ose, në rastin e një personi veçanërisht të rrezikshëm (*particolare pericolosità*), me një urdhër për qëndrim të detyrueshëm në një rreth të caktuar (*obbligo del soggiorno in un determinato comune*).

Vetëm Gjykata e Rrethit e qytetit kryesor të provincës ka fuqinë për të urdhëruar këto masa; ajo e bën këtë bazuar në një kërkesë të arsyetuar nga [*questore*] drejtuar kryetarit të saj (seksioni 4, paragrafi i parë). Gjykata e Rrethit duhet të japë një vendim të arsyetuar (*provvedimento*) në dhoma brenda tridhjetë ditëve. Së pari, do të dëgjojë departamentin e Prokurorit Publik dhe personin në fjalë dhe ky i fundit ka të drejtë të paraqesë deklaratat me shkrim dhe të ndihmohet nga një avokat (neni 4, paragrafi i dytë).

Autoritetet e ndjekjes penale dhe personi i interesuar mund të bëjnë ankim brenda dhjetë ditëve, i cili nuk ka efekt pezullues; Gjykata e Apelit duhet të japë një vendim të arsyetuar (*decreto*) në dhoma brenda tridhjetë ditëve (neni 4, paragrafët e pestë dhe të gjashtë). Ky vendim mundet nga ana tjetër dhe me të njëjtat kushte të jetë objekt i një ankimi të mëtejshëm në Gjykatën e Kasacionit, e cila duhet të japë vendimin e saj në dhoma brenda tridhjetë ditëve (neni 4, paragrafi i shtatë).

49. Kur miraton një nga masat e renditura në seksionin 3, Gjykata e Rrethit specifikon se për sa kohë do të qëndrojë në fuqi masa, jo më pak se një dhe jo më shumë se pesë vjet (neni 4, paragrafi i katërt) dhe jep udhëzime të cilat duhet t'i respektojë personi në fjalë (neni 5, paragrafi i parë).

..."

2. Akti datë 31 maj 1965

17. Akti nr. 575, datë 31 maj 1965 ("Akti i 1965-ës") plotëson Aktin e 1956-ës duke shtuar klauzola kundër mafies (*disposizioni contro la mafia*). Seksioni 1 thotë se ai është i zbatueshëm për personat, të tillë si z. Raimondo, kundër të cilëve ka prova që tregojnë se ata i përkasin grupeve "të tipit mafioz" (*indiziati di appartenere ad associazioni mafiose*).

18. Legjislacioni i mësipërm u forcua me ligjin nr. 646, datë 13 shtator 1982, ("Akti i 1982-it") i cili futi, ndër të tjera, një seksion 2 ter në Aktin e 1965-ës. Ai parashikon masa të ndryshme që do të përdoren gjatë proceseve në lidhje me zbatimin e masave parandaluese të disponueshme sipas Aktit të 1956-ës në lidhje me një person që dyshohet se i përket një organizate të tillë.

"... Gjykata e Rrethit mund të nxjerrë një vendim të arsyetuar, qoftë edhe me kërkesë të saj, për të urdhëruar sekuestrimin e pasurisë në posedim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të personit kundër të cilit është nisur procedimi, kur ka prova të mjaftueshme rrethanore, si p.sh. një mospërputhje e konsiderueshme midis stilit të tij të jetës dhe të ardhurave të tij të dukshme ose të deklaruara, për të treguar se prona në fjalë nuk vjen nga produktet nga aktivitetet e paligjshme ose riinvestimet e tyre.

Bashkë me zbatimin e masës parandaluese, Gjykata e Rrethit urdhëron dhe konfiskimin e çdo malli të sekuestruar për të cilin nuk është dëshmuar se është fituar në mënyrë të ligjshme. Kur hetimet janë komplekse, kjo masë mund të merret edhe në një datë të mëvonshme, por jo më vonë se një vit pas datës së sekuestrimit.

Gjykata e Rrethit revokon urdhrin e sekuestrimit kur rrëzohet kërkesa për masa parandaluese ose kur rezulton se prona në fjalë është fituar në mënyrë të ligjshme.

B. Praktika gjyqësore e lidhur me zbatimin e masave parandaluese, veçanërisht të një natyre materiale

19. Në raportin e tij (paragrafi 43), Komisioni jep një përmbledhje të praktikës gjyqësore në këtë fushë:

" ... Ekzistenca e masave parandaluese nuk është në vetvete në kundërshtim me Kushtetutën italiane. Gjykata Kushtetuese ka vendosur se baza e këtyre masave është nevoja për të garantuar ecurinë e rregullt dhe paqësore të marrëdhënieve shoqërore, jo vetëm nëpërmjet një korpusi legjislativ që penalizon aktet e paligjshme, por edhe nëpërmjet dispozitave që synojnë të pengojnë kryerjen e këtyre akteve (Gjykata Kushtetuese, aktgjykimi nr. 27 i vitit 1959 dhe aktgjykimi nr. 23 i vitit 1964).

Për shkak të objektivit të tyre të veçantë, masat parandaluese nuk kanë të bëjnë me kryerjen e një akti të veçantë të kundërligjshëm, por me një model sjelljeje të përcaktuar me ligj si sjellje që tregon ekzistencën e rrezikut për shoqërinë (Gjykata Kushtetuese, vendimi nr. 23, 1964).

Rrjedhimisht, në sistemin juridik italian ka një dallim thelbësor midis dënimeve penale dhe masave parandaluese. Të parat përbëjnë përgjigjen ndaj një veprimi të paligjshëm dhe pasojave të atij akti; këto të fundit janë një mjet për të parandaluar kryerjen e një veprë të tillë.

Me fjalë të tjera, dënimi penal lidhet me një vepër të kryer tashmë, ndërsa masa parandaluese synon të zvogëlojë rrezikun e veprave të ardhshme (shih, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese, vendimi nr. 53 i vitit 1968, në lidhje me masat e sigurisë).

...

Për shkak se dënimet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo të gjitha parimet kushtetuese që duhet të mbështesin të parën zbatohen domosdoshmërisht për të dytën. Për shembull, prezumimi i pafajësisë i parashikuar në nenin 27 të Kushtetutës nuk ka të bëjë me masat parandaluese, të cilat nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose fajësinë e personit të interesuar (Gjykata Kushtetuese, vendimi nr. 23, 1964).

Në mënyrë të ngjashme, masa të tilla nuk hyjnë në objektin e nenit 25 para. 2 të Kushtetutës, i cili ndalon zbatimin prapaveprues të dispozitave penale. Shkelja e këtij parimi është pretenduar në disa raste në Gjykatën e Kasacionit në lidhje me urdhrat e konfiskimit sipas nenit 2 ter të Aktit të 1965-ës. Gjykata e Kasacionit ka vendosur, së pari, se parimi i mësipërm nuk është i zbatueshëm për masat parandaluese (shih, për shembull, Gjykata e Kasacionit, vendimi *Piraino*, datë 30 janarit 1985). Së dyti, Gjykata e Kasacionit ka vënë në dukje se dispozita e kundërshtuar nuk është në fakt prapavepruese, pasi lidhet me pronën në posedim të personit në fjalë në kohën kur është urdhëruar konfiskimi (Gjykata e Kasacionit, vendimi *Oliveri* i 12 majit 1986) dhe me përdorimin e paligjshëm të asaj prone pas hyrjes së saj në fuqi (Gjykata e Kasacionit, aktgjykimi *Pipitone* i 4 janarit 1985).

Pavarësisht këtyre kufizimeve, masat parandaluese mbeten të hapura për shqyrtimin e plotë të përputhshmërisë së tyre me Kushtetutën.

Që në vitin 1956, Gjykata Kushtetuese vendosi se në asnjë rast e drejta e lirisë nuk mund të kufizohet, përveç rasteve kur një kufizim i tillë parashikohet me ligj, kur ishin nisur procese ligjore të ligjshme për këtë qëllim dhe kur arsyet për këtë ishin përcaktuar në një vendim gjyqësor (Gjykata Kushtetuese, aktgjykimi nr. 11 i vitit 1956).

Më pas, ajo vendosi se masat parandaluese nuk mund të merren vetëm në bazë thjesht të dyshimit dhe justifikohen vetëm kur bazohen në vërtetimin dhe vlerësimin objektiv të fakteve që zbulojnë sjelljen dhe mënyrën e jetesës së personit në fjalë (Gjykata Kushtetuese, vendimi nr. 23, 1964).

Gjykata ka konfirmuar kohët e fundit se kushtetutshmëria e masave parandaluese ende varet nga respektimi i shtetit të së drejtës dhe mundësia e aplikimit në gjykata për një mjet efektiv juridik. Për më tepër, dy kushtet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Pra, nuk mjafton që ligji të tregojë kritere të paqarta për vlerësimin e rrezikut; ai duhet t'i parashtrijë ato me saktësi të mjaftueshme për ta bërë kuptimplotë të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës dhe për procesi gjyqësor me palë kundërshtare (Gjykata Kushtetuese, vendimi nr. 177, 1980).

Praktika gjyqësore e Gjykatës së Kasacionit është në këtë aspekt tërësisht në përputhje me atë të Gjykatës Kushtetuese; ajo pohon fare qartë se proceset gjyqësore për zbatimin e masave parandaluese duhet të jenë me palë kundërshtare dhe të zhvillohen duke respektuar të drejtat e mbrojtjes, dhe çdo shkelje e këtyre të drejtave sjell pavlefshmërinë e tyre (shih, për shembull, Gjykata e Kasacionit, vendimi nr. 1255, datë 29 qershor 1984 në çështjen Santoro).

Gjykata e Kasacionit ka rrëzuar një sërë ankesash që pretendojnë antikushtetutshmërinë e sekuestrimit dhe masave të konfiskimit të parashikuara në seksionin 2 ter të Aktit të 1965-ës. Në veçanti, ajo ka vendosur se prezumimi në lidhje me origjinën e paligjshme të pasurisë së personave të dyshuar se i përkasin organizatave të llojit mafioz nuk është në kundërshtim me nenin 24 të Kushtetutës, i cili garanton të drejtat e mbrojtjes, pasi konfiskimi mund të bëhet vetëm kur ka prova të mjaftueshme rrethore lidhur me origjinën e paligjshme të pronës në fjalë dhe mungesën e kundërshtimit (Gjykata e Kasacionit, aktgjykimi i përmendur më parë Pipitone).

...

Për sa i përket pajtueshmërisë së masave të sekuestrimit dhe konfiskimit me të drejtën për ushtrimin e lirë të veprimtarive ekonomike private dhe të drejtën për gëzimin paqësor të pronës private (nenet 41 dhe 42 të Kushtetutës), Gjykata e Kasacionit ka vendosur se këto të drejta nuk janë absolute dhe mund të kufizohet në përputhje me interesin e përgjithshëm. Kjo vlen në lidhje me pasuritë me origjinë të paligjshme ose përdorimin e tyre (Gjykata e Kasacionit, vendimet e cituara më parë Oliveri dhe Pipitone)

..."

20. Sipas mendimit të tij nr. 1489/86, datë 18 nëntor 1986, *Consiglio di Stato* deklaroi se "ndonëse konfiskimi sipas përkufizimit i mundëson shtetit të fitojë objektin e pasurisë në fjalë ..., ai në vetvete nuk ka efektin e transferimit të pronësisë tek autoritetet publike." Ai ka një efekt të tillë vetëm nëse, përveç kësaj, vendimi që e urdhëron konfiskimin është i parevokueshëm (Gjykata e Rrethit Palermo, urdhër datë 19 prill 1989).

PROCESET PARA KOMISIONIT

21. Z. Raimondo iu drejtua Komisionit më 23 prill 1987. Ai u ankua për sa vijon: (a) paligjshmërinë dhe kohëzgjatjen e ndalimit të tij (neni 5 paragrafët 1 dhe 3 të Konventës) (neni 5-1, neni 5-3); (b) kohëzgjatjen e proceseve të ndryshme gjyqësore në lidhje me të dhe në veçanti proceset penale (neni 6 paragrafi 1) (neni 6-1); (c) mosrespektimin e së drejtës për t'u prezumuar i pafajshëm përderisa ndaj tij janë zbatuar masa parandaluese (neni 6 para. 2) (neni 6-2); (d) detyrimin për të depozituar një garanci për të garantuar respektimin e masave të mësipërme (neni 1 i Protokollit nr. 4) (P4-1); (e) ndërhyrje në pronën e tij për shkak të sekuestrimit dhe konfiskimit të disa prej pasurive të tij (neni 1 i Protokollit nr. 1) (P1-1); dhe (f) fakti që atij i ishte hequr e drejta për lirinë e lëvizjes (neni 2 i Protokollit nr. 4) (P4-2).
22. Më 6 dhjetor 1991, Komisioni e shpalli kërkesën (nr. 12954/87) të pranueshme në lidhje me ankesat e bazuara në të drejtën e ankuesit për gëzimin paqësor të pronave të tij, për lirinë e lëvizjes dhe për një vendim për zbatimin e masave parandaluese brenda një kohe të arsyeshme, ndërsa e gjeti të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës. Në raportin e tij të datës 21 tetor 1992 (hartuar sipas nenit 31) (neni 31), Komisioni shprehu mendimin e mëposhtëm:
- (a) se nuk ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1) në lidhje me sekuestrimin (tetëmbëdhjetë vota pro një kundër) dhe konfiskimin (gjashtëmbëdhjetë vota pro tre kundër) e pasurisë së kërkuarit deri më 31 dhjetor 1986 dhe për dëmin e shkaktuar nga administrimi i pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara deri në atë datë (tetëmbëdhjetë vota pro një kundër);
- (b) se kishte pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (P1-1) për aq sa konfiskimi i nëntë objekteve të pronës së patundshme dhe një kamion kishte vazhduar të ishte në fuqi pas 31 dhjetorit 1986 (me unanimitet);
- (c) se kishte pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4 (P4-2) për aq sa kërkuarit i ishte hequr e drejta për lirinë e lëvizjes nga data 4 korrik deri më 20 dhjetor 1986 (me unanimitet);
- (d) se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 para. 1 (neni 6-1) për sa i përket kohëzgjatjes së proceseve në lidhje me sekuestrimin dhe konfiskimin (me unanimitet).
- Teksti i plotë i opinionit të Komisionit dhe i opinionëve ndryshe të përfshira në raport është riprodhuar si shtojcë e këtij aktgjykimi*.

PARASHTRIMET PËRFUNDIMTARE PARA GJYKATËS NGA QEVERIA

23. Në kërkesën e saj, qeveria i kërkoi Gjykatës "të vendosë dhe të gjykojë se nuk ka pasur shkelje as të Konventës, as të Protokolleve Nr. 1 dhe 4".

* Shënim i sekretarit: për arsye praktike kjo shtojcë do të shfaqet vetëm me versionin e printuar të vendimit (vëllimi 281-A i Serisë A të Botimeve të Gjykatës), por një kopje e raportit të Komisionit mund të merret në sekretari.

LIDHUR ME LIGJIN

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 (P1-1)

24. Raimondo u ankua për sekuestrimin më 13 maj 1985 të gjashtëmbëdhjetë objekteve prone të patundshme dhe gjashtë automjeteve, dhe konfiskimin e disa prej këtyre pasurive të urdhëruar më 16 tetor 1985 (shih paragrafin 13 më lart). Ai u mbështet në nenin 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1), i cili parashikon si më poshtë

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit të qetë të pronës së tij. Askush nuk mund të privohet nga pronat e tij, përveçse për interesin publik dhe në varësi të kushteve të parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mësipërme nuk cenojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligje të tilla të cilat ai i sheh të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm, ose për të siguruar pagesën e taksave ose kontributeve ose gjobave të tjera.

25. Për të përcaktuar nëse masat e kontestuara përbëjnë kontroll të "përdorimit të pronës" sipas kuptimit të paragrafit të dytë ose përbëjnë privim të pasurisë sipas paragrafit të parë, Gjykata së pari do të shqyrtojë zbatimin e tyre deri më 31 dhjetor 1986, kohë kur vendimi i Gjykatës së Apelit Catanzaro mori formë të prerë (shih paragrafin 14 më lart). Më pas do të shqyrtojë çështjen e vazhdimin të regjistrimit të tyre në regjistrat publikë pas asaj date (shih paragrafin 15 më lart).

A. Zbatimi i masave parandaluese lidhur me pronat deri më 31 dhjetor 1986

26. Qeveria nuk e mohoi se kishte pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkuarit për gëzimin paqësor të pronave të tij. Megjithatë, ajo pretendoi se sekuestrimi dhe konfiskimi ishte i justifikuar në bazë të përjashtimeve të lejuara sipas nenit 1 (P1-1) nga parimi i përcaktuar në fjalinë e parë të kësaj dispozite.

1. Sekuestrimi

27. Ashtu si Komisioni, Gjykata konstaton se sekuestrimi parashikohej në seksionin 2 ter të Aktit të vitit 1965 (shih paragrafin 18 më lart) dhe nuk synonte t'i privonte kërkuarit pronat e tij, por vetëm ta pengonte atë nga përdorimi i tyre. Prandaj është paragrafi i dytë i nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1) i cili është i rëndësishëm për këtë pikë.

Përveç kësaj, kërkuari nuk pretendon se më 13 maj 1985 ishte e paarsyeshme për Gjykatën e Rrethit të vlerësonte se kishte prova të mjaftueshme rrethanore për të treguar se pasuritë e sekuestruara përfaqësonin produkte të prodhuara nga aktivitetet e paligjshme ose riinvestimi i tyre. Ajo për të cilën ankohet kërkuari është marrja e një mase kaq drastike në këtë fazë të procesit. Megjithatë, sekuestrimi sipas nenit 2 ter të Aktit të 1965 është qartësisht një masë e përkohshme, e cila synon të sigurojë që prona që duket të jetë fryt i aktiviteteve të paligjshme të kryera në dëm të komunitetit më pas të mund të konfiskohet, nëse është e nevojshme.

Prandaj, masa, si e tillë, justifikohet nga interesi i përgjithshëm dhe, duke pasur parasysh fuqinë ekonomike jashtëzakonisht të rrezikshme të një "organizate" si mafia, nuk mund të thuhet se marrja e saj në këtë fazë të procesit nuk ishte në proporcion me qëllimin e ndjekur.

Për rrjedhojë, lidhur me këtë pikë, nuk vërtetohet shkelje e nenit 1 të Protokollit. 1 (P1-1).

2. Konfiskimi

28. Sipas parashtrimit të kërkuarit, edhe nëse pranohej se konfiskimi nuk e kishte privuar atë nga pronësia mbi pasurinë së tij, regjistrimi në regjistrat publikë përfaqësonte një formë të zbatimit të masës përpara se të merrej një vendim për kundërshtimin e saj.

29. Megjithatë përfshin një privim të pasurisë, konfiskimi i pronës nuk hyn domosdoshmërisht në fushëveprimin e fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1) (shih Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 7 dhjetorit 1976, Seria A nr. 24, f. 30, paragrafi 63, dhe aktgjykimi AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 24 tetorit 1986, Seria A nr.108, f.17, para. 51).

Sipas praktikës gjyqësore italiane, konfiskimi i llojit që është në diskutim në këtë çështje nuk mund të kishte efektin e transferimit të pronësisë tek shteti derisa të kishte një vendim të përvokueshëm (shih paragrafin 20 më lart). Nuk kishte një vendim të tillë në këtë rast, sepse z. Raimondo kishte kundërshtuar urdhrin e Gjykatës së Rrethit Catanzaro, datë 16 tetor 1985 (shih paragrafin 13 më lart). Prandaj edhe këtu zbatohet paragrafi i dytë i nenit 1 (P1-1).

30. Ashtu si Qeveria dhe Komisioni, Gjykata vëren se konfiskimi, i parashikuar gjithashtu në seksionin 2 të Aktit të vitit 1965, ndoqi një qëllim që ishte në interesin e përgjithshëm, domethënë kërkonte të siguronte që përdorimi i pronës në diskutim nuk kishte siguruar për kërkuarin, ose organizatën kriminale të cilës ai dyshohej se i përkiste, avantazhe në dëm të komunitetit.

Gjykata është plotësisht e vetëdijshme për vështirësitë e hasura nga shteti italian në luftën kundër mafies. Si rezultat i aktiviteteve të saj të paligjshme, veçanërisht trafikimit të drogës dhe lidhjeve të saj ndërkombëtare, kjo "organizatë" ka një qarkullim të madh që investohet më pas, ndër të tjera, në sektorin e pronave të patundshme. Konfiskimi, i cili synon të bllokojë këto lëvizje të kapitalit të dyshuar, është një armë efektive dhe e nevojshme në luftën kundër këtij kanceri. Prandaj, duket proporcionale me qëllimin e ndjekur, aq më tepër sepse në fakt nuk sjell asnjë kufizim shtesë në lidhje me sekuestrimin.

Së fundi, qëllimi parandalues i konfiskimit justifikon zbatimin e menjëhershëm të tij, pavarësisht çdo ankimi.

Si përfundim, shteti i paditur nuk ka tejkalluar pragun e vlerësimit që i është lënë sipas paragrafit të dytë të nenit 1 (P1-1)

3. Mbikëqyrja e pronës së sekuestruar dhe konfiskuar

31. Përsëri duke u mbështetur në nenin 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1), z. Raimondo pretendoi se, duke qenë se policia bashkiake kishte dështuar të kryente një mbikëqyrje të duhur,

prona që i nënshtrohej masave parandaluese kishte qenë objekt i vandalizmit të gjerë.

32. Qeveria e mohoi këtë. Sa i takon statusit zyrtar të atyre që janë përgjegjës për ruajtjen e pronës, pra oficerëve të policisë bashkiake të caktuar nga autoritetet gjyqësore, nuk përlligjej asnjë akuzë për neglizhencë ndaj tyre. Për më tepër, në vitin 1989 ishte miratuar një ligj për të rregulluar këtë çështje, së pari duke mbrojtur interesat e personave të cilëve u është kthyer prona pas sekuestrimit dhe, së dyti, për të treguar përdorimin në interes publik për pronën e sekuestruar dhe më pas të konfiskuar në mënyrë të përhershme.

33. Ashtu si edhe Komisioni, Gjykata vëren se çdo sekuestrim ose konfiskim sjell në mënyrë të pashmangshme dëm. Komisioni konstatoi se pretendimet e kërkuesit nuk ofronin bazë mjaftueshmërisht të qartë për të shqyrtuar nëse dëmi aktual i pësuar në këtë çështje e tejkalonte një dëm të tillë të pashmangshëm. Para Gjykatës kërkuesi nuk dha asnjë informacion më konkret. Për rrjedhojë, Gjykata nuk mund të mos miratojë qasjen e Komisionit dhe të vlerësojë se edhe në këtë pikë nuk është konstatuar shkelje e nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1).

B. Fakti që masat e kontestuara mbetën të hedhura në regjistrat publikë pas datës 31 dhjetor 1986

34. Sipas kërkusit, autoritetet kompetente vonuan zbatimin e vendimit të Gjykatës së Apelit të Catanzaros, datë 4 korrik 1986.

35. Qeveria pohoi se prona e patundshme dhe pronat e tundshme ishin kthyer më 2 shkurt 1987, vetëm dy muaj pasi vendimi i lartpërmendur ishte depozituar në sekretari. Ajo pranoi se formalitetet për regjistrimin në regjistrat publikë të revokimit të masave të kontestuara kishin marrë ca kohë, por z. Raimondo mund dhe duhej të kishte kontaktuar departamentin përkatës me një kopje të vendimit për revokimin e masave. Neni 619 i ish Kodit të Procedurës Penale, i cituar nga avokati i qeverisë në seancë, nuk ishte i zbatueshëm sepse kishte të bënte ekskluzivisht me anulimin nga organet e ndjekjes penale të hipotekave ose sekuestrimeve të urdhëruara për të siguruar pagimin e borxheve të të pandehurit pas dënimit të tij (shpenzimet gjyqësore, gjoba dhe shpenzimet e burgut).

36. Gjykata vëren në radhë të parë se pronat në fjalë iu kthyen kërkuesit më 2 shkurt 1987, dy muaj pasi vendimi i Gjykatës së Apelit u depozitua në sekretari. Megjithatë, ajo duhet të shqyrtojë nëse fakti që pronat mbetën të regjistruara në regjistrat përkatës përbën ndërhyrje në të drejtën e garantuar sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1).

Asnjë ndërhyrje e tillë nuk ka ndodhur në lidhje me pronën e patundshme të sekuestruar më 13 maj 1985 dhe me tre nga automjetet e konfiskuara më 16 tetor 1985, sepse hedhjet e nevojshme (në regjistra) u bënë me shpejtësi, më 2 dhe 10 shkurt 1987 (shih paragrafin 15 më lart). Nga ana tjetër, ka pasur ndërhyrje në lidhje me kamionin dhe nëntë objektet e pasurisë së patundshme të konfiskuara më 16 tetor 1985, pasi hedhja në regjistër e kamionit nuk është bërë deri më 10 korrik 1987 dhe hedhja në regjistër e pronës së patundshme nuk ka ndodhur më parë se 9 gushti 1991 (shih paragrafin 15 më lart).

Nuk i takon Gjykatës të përcaktojë se kush duhet të kishte ndërmarrë hapat e duhur lidhur me këtë pikë. Megjithatë, dhe pavarësisht arsyeve të parashtruara nga Qeveria, këtu përfshihet përgjegjësia e autoriteteve. Gjykata e ka të vështirë të kuptojë pse ishte e nevojshme të pritej përkatësisht më shumë se shtatë muaj (2 dhjetor 1986 - 10 korrik 1987) dhe katër vjet e tetë muaj (2 dhjetor 1986 - 9 gusht 1991) përpara se të rregullohej statusi ligjor i disa prej pronave të z. Raimondo, kur Gjykata e Apelit e Catanzaros kishte urdhëruar që e gjitha pronat t'u ktheheshin pronarëve "pasi ato të ishin hequr nga regjistrat" (*previa cancellazione delle formalita concernenti le eseguite trascrizioni*).

Për më tepër, kjo ndërhyrje nuk ishte as "e parashikuar me ligj" dhe as e nevojshme "për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm" sipas kuptimit të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1).

Për rrjedhojë, ka shkelje të kësaj dispozite.

II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 2 TË PROTOKOLLIT NR. 4 (P4-2)

37. Kërkuesi u ankua se mbikëqyrja e posaçme e policisë nën të cilën ai ishte vendosur përbënte shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4 (P4-2), i cili parashikon se:

"1. Çdokush në mënyrë të ligjshme brenda territorit të një shteti, brenda atij territori, ka të drejtën e lirisë së lëvizjes dhe lirinë për të zgjedhur vendbanimin e tij.

...

3. Asnjë kufizim nuk do të vendoset në ushtrimin e këtyre të drejtave, përveç atyre që janë në përputhje me ligjin dhe janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose të sigurisë publike, për ruajtjen e rendit publik, për parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

..."

38. Qeveria e kundërshtoi këtë pikëpamje. Vendimi i miratuar në seancë private, për revokimin e mbikëqyrjes së posaçme, nuk kishte marrë fuqi juridike, sipas dispozitave përkatëse, deri në ditën kur ishte depozituar në sekretari, përkatësisht më 2 dhjetor 1986. Deri në atë moment ajo kishte qenë "thjesht një zhvillim i brendshëm". Gjykata e Apelit Catanzaro nuk mund të kritikohet se nuk kishte arritur të jepte vendimin e saj brenda tridhjetë ditëve, siç parashikohet në seksionin 4 të Aktit të vitit 1956, sepse ai afat nuk ishte i detyrueshëm.

39. Gjykata vlerëson në radhë të parë se, pavarësisht pohimit të kërkuesit për të kundërtën, masa në fjalë nuk përbënte heqje lirie sipas kuptimit të nenit 5 para. 1 (neni 5-1) të Konventës. Thjesht kufizimet e lirisë së lëvizjes që rrjedhin nga mbikëqyrja e posaçme duhet të trajtohen sipas nenit 2 të Protokollit nr. 4 (P4-2) (shih vendimin Guzzardi kundër Italisë, cituar më sipër, f. 33, para. 92).

Duke marrë parasysh kërcënimin e paraqitur nga mafia për "shoqërinë demokratike", masa ishte gjithashtu e nevojshme "për ruajtjen e rendit publik" dhe "për parandalimin e krimit". Ajo ishte në veçanti proporcionale me qëllimin e ndjekur, deri në momentin kur Gjykata e Apelit Catanzaro vendosi, më 4 korrik 1986, ta revokonte atë (shih paragrafin 14 më lart).

Mbetet të shqyrtohet periudha ndërmjet datës 4 korrik dhe datës 20 dhjetor 1986, kur vendimi iu njoftua kërkuesit (shih të njëjtin paragraf). Edhe nëse pranohet se ky vendim, i marrë në seancë private, nuk mund të merrte fuqi juridike derisa të depozitohet në sekretari, Gjykata e ka të vështirë të kuptojë se përse duhet të kishte një vonesë prej afro pesë muajsh për të hartuar arsyetimin e një vendimi i cili ishte menjëherë i zbatueshëm dhe kishte të bënte me një të drejtë themelore, domethënë lirinë e kërkuesit për të ardhur dhe për të shkuar sipas dëshirës. Për më tepër, kërkuesi u informua për revokimin tetëmbëdhjetë ditë më pas vendimit.

40. Gjykata arrin në përfundimin se të paktën nga data 2 deri më 20 dhjetor 1986 ndërhyrja në fjalë nuk ishte as e parashikuar me ligj dhe as e nevojshme. Rrjedhimisht, ka shkelje të nenit 2 të Protokollit Nr. 4 (P4-2).

III. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 PARA. 1 I KONVENTËS (neni 6-1)

41. Raimondo në fund kritikoi kohëzgjatjen e proceseve në lidhje me ankesën e tij kundër konfiskimit dhe mbikëqyrjes së posaçme. Ai është mbështetur në nenin 6 para. 1 (neni 6-1) të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

" Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile dhe për çdo akuzë penale kundër tij, çdokush ka të drejtë për një ... seancë gjyqësore brenda një kohe të arsyeshme nga [një] ... gjykatë ..."

42. Periudha që do të shqyrtohet fillon më 16 tetor 1985, data kur Gjykata e Rrethit Catanzaro urdhëroi masat në fjalë (shih paragrafin 13 më lart). Ajo përfundon më 31 dhjetor 1986, kur vendimi i Gjykatës së Apelit mori formë të prerë. Pra, kohëzgjatja ishte një vit, dy muaj dhe dy javë.

43. Gjykata ka të njëjtin qëndrim si Qeveria dhe Komisioni, përkatësisht se mbikëqyrja e posaçme nuk është e krahasueshme me një sanksion penal, sepse ajo është krijuar për të parandaluar kryerjen e veprave. Nga kjo del si përfundim se proceset në lidhje me të nuk përfshinin "përcaktimin ... e një akuze penale" (shih vendimin e Guzzardi të cituar më lart, f. 40, para. 108)

Sa i takon çështjes së konfiskimit, duhet theksuar se neni 6 (neni 6) zbatohet për çdo veprim fushëveprimi i të cilit është "material" në natyrë dhe që bazohet në një shkelje të pretenduar të të drejtave po ashtu të një karakteri material (shih vendimin Editions Periscope kundër Francës, datë 26 mars 1992, Seria A nr. 234-B, f.66, para. 40). Ky ishte pozicioni në çështjen konkrete.

44. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se çështja u paraqit para dy gjykatave të brendshme, Gjykata nuk e konsideron kohëzgjatjen e përgjithshme të procesit si të paarsyeshme (shih, *mutatis mutandis*, vendimin Salerno kundër Italisë, datë 12 tetor 1992, Seria A nr 245-D, f. 56, para. 21)

Për arsyet e dhëna më lart, përfundimi është që nuk ka shkelje të nenit 6 para. 1 (neni 6-1).

IV. ZBATIMI I NENIT 50 (neni 50) TË KONVENTËS

45. Sipas nenit 50 (neni 50) të Konventës:

"Nëse Gjykata konstaton se një vendim ose një masë e marrë nga një autoritet ligjor ose ndonjë autoritet tjetër i një Pale të Lartë Kontraktuese është plotësisht ose pjesërisht në kundërshtim me detyrimet që rrjedhin nga ... Konventa, dhe nëse ligji i brendshëm i kësaj Pale lejon vetëm dëmshpërblimin e pjesshëm për pasojat e këtij vendimi ose mase, vendimi i Gjykatës, nëse është e nevojshme, i jep kompensim të drejtë palës së dëmtuar."

A. Dëmshpërblimi

46. Z. Raimondo kërkoi kompensim për dëmin material dhe jomaterial të pësuar pa dhënë një shifër për kompensimin. Kjo kërkesë bazohej në faktin që atij iu desh të ndalonte punën ndërtimore pas konfiskimit të pronës dhe që kushtet e pakënaqshme në të cilat ishin mbajtur ndërtesat dhe automjetet kishin çuar në përkeqësim të konsiderueshëm të tyre. Vendosja e mbikëqyrjes së posaçme e kishte bërë të vështirë lëvizjen e tij dhe të pamundur kryerjen e biznesit të tij. Përveç kësaj, vonesa në hedhjen në regjistër të revokimit të konfiskimit kishte bërë që çdo përpjekje për të zotëruar pronën në fjalë të kishte dështuar, gjë që kishte çuar në një rritje të borxheve, të cilat tashmë ishin bërë të mëdha.

47. Sipas Qeverisë, kërkuesi nuk demostroi se shkeljet e pretenduara kishin çuar në dëme materiale. Për sa i përket dëmeve jomateriale, ajo ishte e mendimit se, nëse do të konstatohej një shkelje, konstatimi në vetvete do të ofronte një kompensim mjaftueshëm të drejtë.

48. Përfaqësuesi i Komisionit u shpreh se kërkuesi pa dyshim kishte pësuar dëme materiale dhe jomateriale. Megjithatë, në mungesë të ndonjë pretendimi specifik, ai ishte i pasigurt për qasjen që do të zbatohet.

49. Gjykata hedh poshtë pretendimet për dëm material pasi formulimi i këtyre pretendimeve është shumë i paqartë dhe informacioni i përfshirë në dosje nuk ndihmon për të sqaruar çështjen. Nga ana tjetër, ajo mendon se z. Raimondo ka pësuar disa dëme jomateriale për të cilat i jep atij 10,000,000 lira italiane.

B. Kostot dhe shpenzimet

50. Në seancë, avokati i kërkuesit kërkoi rimbursimin e 10,552,325 lirave (duke përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar) në lidhje me kostot dhe shpenzimet e bëra për përfaqësim para institucioneve të Konventës.

51. Qeveria e la këtë çështje në vlerësimin e Gjykatës, por vuri në dukje se shumica e dhënës duhet të jetë proporcionale me nivelin e suksesit, nëse ka, të kërkesës së z. Raimondo.

Përfaqësuesi i Komisionit nuk shprehu një opinion mbi këtë çështje.

52. Duke pasur parasysh rrëzimin e disa prej ankesave të z. Raimondo, Gjykata, duke pasur parasysh provat në dispozicion dhe praktikës gjyqësore përkatëse, i jep atij 5,000,000 lira.

PËR ARSYET E PËRMENDURA MË LART, GJYKATA UNANIMISHT

1. Vendos se nuk është konstatuar asnjë shkelje e nenit 1 të Protokollit nr. 1 (P1-1) në lidhje me sekuestrimin dhe me konfiskimin e pasurisë së kërkuarit deri më 31 dhjetor 1986, dhe as në lidhje me dëmin e shkaktuar nga këto masa;
2. Vendos se ka pasur një shkelje të të njëjtit nen (P1-1) lidhur me konfiskimin, më 16 tetor 1985, e një kamioni dhe nëntë objekteve pasuri e patundshme të mbetura të regjistruara në regjistrat përkatës pas datës 31 dhjetorit 1986 dhe se nuk është konstatuar shkelje tjetër e kësaj dispozite;
3. Vendos se ka pasur shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 4 (P4-2) të paktën për atë që mbikëqyrja e posaçme policore ndaj kërkuarit ka vazhduar pas datës 2 dhjetor 1986;
4. Vendosi se neni 6 (neni 6) i Konventës nuk zbatohet për mbikëqyrjen e posaçme në fjalë;
5. Konstaton se nuk ka pasur shkelje të kësaj dispozite për sa i përket kohëzgjatjes së proceseve të konfiskimit;
6. Vendos se shteti i paditur duhet t'i paguajë z. Raimondo, brenda tre muajve, 10,000,000 (dhjetë milionë) lira italiane për dëmin jomaterial dhe 5,000,000 (pesë milionë) lira italiane për kostot dhe shpenzimet.
7. Hedh poshtë pjesën e mbetur të pretendimeve të kërkuarit për shpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht dhe në frëngjisht, dhe dorëzuar në seancë publike në Ndërtësën e të Drejtave të Njeriut, Strasburg, më 22 shkurt 1994.

Marc-Andre EISSEN
Sekretar

Rolv RYSSDA
President